



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 757/3 Prot.

Tiranë, më 07-03 2023

VENDIM

Nr. 35 dt. 07-03 2023

“PËR
MIRATIMIN E PËRCJELLJES SË DOKUMENTACIONIT
TË DR. GENTI PANO PËR FITIMIN E TITULLIT “PROFESOR I ASOCIUAR”
PRANË KPPA”

Në zbatim të nenit 38, 60 pika 3, 79 pika 7 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, kreut IV pika 1 dhe 2 të V.K.M-së nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, nenit 20, 27 të Statutit të UST-së, nenit 7 të Rregullores së UST-së, nenit 4, 7 dhe 13 të Rregullores së Veprimtarisë së Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së, mbështetur në shkresën e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit nr.2130/9 prot., datë 17.02.2023 “Përcjellje e dokumentacionit të kandidatit Dr. Genti Pano, për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar”, shkresën e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit nr.48/1 prot., datë 08.02.2023 “Përcjellja e raportit të nëjsisë kryesore, për dosjen e kandidatit Dr. Genti Pano, për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 07.03.2023,

V E N D O S I :

1. Të miratojë përcjelljen e dokumentacionit të Dr. Genti Pano për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar”, pranë Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së.
2. Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik të vijojë me procedurat sipas kuadrit ligjor në fuqi.

3. Një kopje e këtij vendimi t'i përcillet Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik, Njesisë Kryesore Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

